



Drejtuar: Operatorit ekonomik “Alko Impex general Constructions” degë e shoqërisë së huaj

Adresa: Rr.“Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga, Kati 8, prane Stacionit te Trenit, Tirane.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar” “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”.

Fondi limit: 494,683,652 (katërqind e nëntëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2018, miratuar me VKB Nr. 132, datë 21.12.2017 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2018 – 2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”.

- **Viti I** - fondi prej: **164,894,551** (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e tetëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH
- **Viti II** - fondi prej: **164,894,551** (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e tetëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH
- **Viti III**- fondi prej: **164,894,551** (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e tetëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH;

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2018, miratuar me VKB Nr. 132, datë 21.12.2017 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2018 – 2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”.

Kohëzgjatja e kontratës: 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë kalendarike x 3 (tre) vite nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 27.09.2017, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 29 datë 24.07.2017.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Pastrime Silvio" shpk & "ER.Cav" srl
NUIS K91413010N & NUIS BA-574208

Vlera e ofertës = 440,306,450.1 (katërqind e dyzetë milion e treqind e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë pikë një) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik "Victoria Invest" shpk NUIS K32712206U

Vlera e ofertës = 455,120,199 (katërqind e pesëdhjetë e pesë milion e njëqind e njëzetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH

3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Shpresa" shpk & "Dion Texnikh A.E"
NUIS K67917301H & NUIS 094413212

Vlera e ofertës = 460,308,404.40 (katërqind e gjashtëdhjetë milion e treqind e tetë mijë e katërqind e katër pikë dyzetë) lekë pa TVSH

4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Korsel" shpk & "Brai Cata" srl
NUIS J64104124G & NUIS 13627967

Vlera e ofertës = 470,663,330.29 (katërqind e shtatëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e e tridhjetë pikë njëzetë e nëntë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik "Alko Impex General Construction" degë e shoqërisë së huaj NUIS K91326028I

Vlera e ofertës = 473,765,974 (katërqind e shtatëdhjetë e tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH

6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "BE-IS" shpk & "Sea" srl & "Egland" shpk
NUIS K71412003A & NUIS J96829419D

Vlera e ofertës = 484,329,326 (katërqind e tetëdhjetë e katër milion e treqind e njëzetë e nëntë mijë e treqind e njëzetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

7. Operatori Ekonomik "Fusha" shpk NUIS J61922018S

Vlera e ofertës = 492,006,962 (katërqind e nëntëdhjetë e dy milion e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

8. Operatori Ekonomik "Ante-Group" shpk NUIS J62904100D

Vlera e ofertës = 492,710,902 (katërqind e nëntëdhjetë e dy milion e shtatëqind e dhjetë mijë e nëntëqind e dy) lekë pa TVSH.

9. Operatori Ekonomik "Rej" shpk

NUIS J93711608Q

Vlera e ofertës = 493,969,649 (katërqind e nëntëdhjetë e tre milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dyzetë e nëntë) lekë pa TVSH

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Pastrime Silvio" shpk & "ER.Cav" srl

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë Pastrime Silvio" shpk & "ER.Cav" srl nuk plotëson pikën 3 të Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit: *"Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen: a.Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b. Prokura e posaçme"*, pasi në kontratën e bashkëpunimit nuk janë përcaktuar zërat e detajuar të shërbimit që do të ofrojnë secili nga operatorët ekonomikë pjesë e bashkimit ekonomik cka bie në kundërshtim me Kreut VIII Nenit 74 pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar), "Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe **elementet konkrete**, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi" dhe vlera e përqindjes së përfaqësimit në kontratën e bashkëpunimit nuk përkon me vlerën e ndarjes së zërave të shërbimit në preventiv, që do të ofrohen nga secili operator, pra Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton dy vlera të ndryshme përfaqësimi.
- Operatori ekonomik "Pastrime Silvio" shpk nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: *"Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim"*, pasi për drejtuesin teknik, Diploma është paraqitur fotokopje e pashoqëruar me vërtetimin e Noterizimit/njehsim i kopjes origjinale me atë fotokopje.
- Operatori ekonomik "Pastrime Silvio" shpk nuk plotëson pikën 2 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *"Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për Zonën Tirana – III, i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:Librezë pune (përkatëse), Diplomë , CV përkatëse, Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar më sipër, Drejtuesi Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës në ofrimin e shërbimit të pastrimit"*, pasi CV rezulton e panënshkruar nga Drejtuesi Teknik.
- Operatori ekonomik "Pastrime Silvio" shpk nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: *"Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim"*, pasi për

inxhinierin e mjedisit, dokumentacioni eshte paraqitur fotokopje i pashoqëruar me vërtetimin e Noterizimit/njehsim i kopjes origjinale me atë fotokopje.

- Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“1 (një) Inxhinier Mjedisit, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, librezë pune dhe Çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisit”, pasi nuk ka paraqitur Çertifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisit për Inxhinierin e Mjedisit por për Inxhinierin Kimist çka bie në kundërshtim me kriterin e sipërcituar.*
- Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”,* pasi për inxhinierin mekanik, dokumentacioni eshte paraqitur fotokopje i pashoqëruar me vërtetimin e Noterizimit/njehsim i kopjes origjinale me atë fotokopje.
- Operatori ekonomik “Pastrime Silvio” shpk nuk plotëson pikën 2 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për Zonën Tirana – III, i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: Librezë pune (përkatese), Diplomë, CV përkatese, Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme). Në rast të mosplotësimit në këtë kontratë të eksperiencës 5 vjeçare të punës së kërkuar më sipër, Drejtuesi Teknik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga punëdhënësi i mëparshëm për eksperiencën e punës në ofrimin e shërbimit të pastrimit”,* pasi CV rezulton e panënshkruar.
- Operatori ekonomik “Er.Cav” shpk nuk plotëson pikën 2 të Kapacitet Ekonomik dhe Financiar të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2014, 2015, 2016) lëshuar nga Autoriteti përkates, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: 494,683,652 (katërqind e nëntëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH”,* pasi në deklaratën e paraqitur për xhiron është përcaktuar se operatori ekonomik “Er.Cav” shpk është një shoqëri e krijuar në datë 26.11.2014 dhe si rrjedhojë nuk ka prodhuar të ardhura për vitin 2014, në vitin 2015 aktiviteti ka filluar në muajin dhjetor dhe viti 2016 rezulton viti i parë me aktivitet të plotë.

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Victoria Invest” shpk

- Operatori ekonomik “Victoria” shpk nuk plotëson pikën 11 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatese për mjetet e mëposhtme...”,* pasi nuk është paraqitur një deklaratë mbi disponueshmërinë ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë e mjeteve të kërkuara.
- Operatori ekonomik “Victoria” shpk nuk plotëson pikën 12, gërma “e” të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin*

për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhe të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (origjinal ose kopje e noterizuar)”, pasi për mjetet e porositura nëpërmjet kontratës së porosisë me subjektin “Autovision” (IVECO), Nr. 581.Rep, datë 26.09.2017 në katalogët e paraqitur jepen të dhëna vetëm për kokën e makinerive dhe jo pjesën e karrocërisë së tyre, pra materiali viziv i paraqitur nuk përmban të dhëna teknike/specifikimet cka bie në kundërshtim me pikën 11 (a-f).

- Operatori ekonomik “Victoria” shpk nuk plotëson pikën 12, të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë.....”, pasi referuar kontratës së porosisë me subjektin “Autovision” (IVECO), Nr. 581.Rep, datë 26.09.2017 dhe kontratës së shitjes me kusht me subjektin “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S”, Nr.588.Rep, datë 27.09.2017, nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur rezulton paraqitja e mjeteve të njëjta nga dy subjekte të ndryshme, e dëshmuar me të njëjtat foto.
- Operatori ekonomik “Victoria” shpk nuk plotëson pikën 12, të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë.....”, pasi në dokumentacionin bashkëlidhur kontratës së shitjes me kusht me subjektin “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S”, nuk ekziton asnjë lidhje pronësie mbi mjetet nga ana e shitësit, subjektit “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S”.
- Operatori ekonomik “Victoria” shpk nuk plotëson pikën 12, të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë.....”, pasi në kontratën e shitjes me kusht me subjektin “Gentek Lojistik temizlik Makin eve Endustriyel Urunler A.S”, Nr.588.Rep, datë 27.09.2017 nuk është përcaktuar specifikisht objekti i procedurës së prokurimit, konkretisht:” **Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III**”

3. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” shpk & “Dion Texnikh A.E”;

- Bazuar në vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shpresa” shpk & “Dion Texnikh” A.E nuk plotëson pikën 3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2017” pasi referuar Ekstraktit të Regjistrimit Tregëtar të shoqërisë “Shpresa” shpk, në të cilën rezulton se vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit në Qarkun Berat janë si më poshtë vijon: Berat, Lagjja Kushtrim, Spitali Rajonal dhe Berat, Poshnje, Kati i Pare, Reparti Ushtarak Nr.1030 Poshnje, ndërkohë që shoqëria “Shpresa” shpk nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2017 nga Bashkia Berat cka bie në kundërshtim me pikën 2 të nenin 11 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.
- Bazuar në vendimin e KSHA, referuar dokumentacionit të marrë në konsideratë dy vërtetimet e lëshuara nga Bashkia Selanik Nr. 76080/18750 dhe Nr. 76083/18751 nuk janë të njëjta me ato të dorëzuar në SPE si edhe për kontratën e bashkëpunimit mes shoqërive dhe prokurën e lëshuar nuk janë nënshkruar para noterit pasi administratori D.D nuk ka hyrë asnjëherë në Republikën e Shqipërisë. Bazuar në nenin 47 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), keto fakte të ngritura në

pretendim janë derguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.

4. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Korsel” shpk & “Brai Cata” srl;

- Operatori ekonomik “Korsel” shpk me anë të shkresës Nr.18.Prot, datë 20.10.2017, hyrë në Bashkinë e Tiranës me Nr. 38338.Prot, datë 20.10.2017, ka kërkuar tërheqjen nga pjesëmarrja, klasifikimi dhe vlerësimi për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”, duke deklaruar mungesën e kapaciteteve të nevojshme për këtë procedurë prokurimi. (Administruar në dosjen e prokurimit).

5. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “BE-IS” shpk &”Sea” srl &”Egland” shpk

- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 1 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Shërbime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht” pasi janë paraqitur kontrata me objekt rikonstruksion rrugësh, godinash, kanalizime dhe jo kontrata ofrimi i shërbimit të pastrimit, cka nuk konsiderohet shërbime të së njëjtës natyre/ngjashme.
- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 13, gërma “b” të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Kontenieret e marra me qira apo të porositura duhet të shoqërohen me kontratë qiraje apo porosie (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë/porosisë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të konteniereve/afatin e ekzekutimit të porosisë (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi)*” pasi kontrata e porosisë me kusht me subjektin “YENI BALKAN MAKINA” rezulton e paplotë, mungon Aneksi 1, ku duhet të përcaktohen sasia e konteniereve.
- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 9 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (për pastrim, larje dhe fshirje rrugësh), (Kodi III.1.A)*” pasi nuk disponon lejen mjedisore të sipërcituar për veprimtarinë objekt prokurimi.
- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: “*Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim*”, pasi për Mjekun e Përgjithshëm dhe Inxhinierin Mekanik, Diplomat janë paraqitur fotokopje të pashoqëruara me vërtetimin e Noterizimit/njehsim i kopjes origjinale me atë fotokopje.
- Operatori ekonomik “Egland” shpk nuk plotëson pikën 9 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Leje Mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit (për pastrim, larje dhe fshirje rrugësh), (Kodi III.1.A)*” pasi nuk disponon lejen mjedisore në kategorinë e kërkuar (për pastrim, larje dhe fshirje rrugësh).
- Operatori ekonomik “Egland” shpk nuk plotëson pikën 9 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)*” pasi nuk disponon lejen mjedisore në kategorinë e kërkuar (për pastrim, larje dhe fshirje rrugësh).
- Operatori ekonomik “Egland” shpk nuk plotëson pikën 1 të Kapacitetit teknik të

Dokumentave Standarte të Tenderit: "Shërbime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht" pasi janë paraqitur kontrata me objekt rikonstruksion rrugësh, godinash, kanalizime dhe jo kontrata ofrimi i shërbimit të pastrimit, cka nuk konsiderohet shërbime të së njëjtës natyre/ngjashme.

- Operatori ekonomik "Sea" srl nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: "*Kandidati, ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër: Operatorët e huaj ekonomikë duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe t'i certifikojnë me vulën "Apostille". Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e këtyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s'kualifikues", pasi për drejtuesin teknik të deklaruar, Diploma është paraqitur pa Vulën Apostile.*
- Operatori ekonomik "Sea" srl nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: "*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 9001 – 2008 për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikatën ISO)*" pasi nuk ka paraqitur certifikatën **ISO 9001 – 2008**.
- Operatori ekonomik "Sea" srl nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: "*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 14001 – 2004 për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikatën ISO)*" pasi nuk ka paraqitur certifikatën **ISO 14001 – 2004**.
- Operatori ekonomik "Sea" srl nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: "*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë BS OHSAS 18001 – 2007 për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikatën ISO)*" pasi nuk ka paraqitur certifikatën **BS OHSAS 18001 – 2007**.

6. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "Fusha" shpk

- Operatori ekonomik "Fusha" shpk nuk plotëson pikën 11 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme...*", pasi nuk është paraqitur një deklaratë mbi disponueshmërinë ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë e mjeteve të kërkuara.
- Operatori ekonomik "Fusha" shpk nuk plotëson pikën 12, gërma "e" të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: "*Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (origjinal ose kopje e noterizuar)",* pasi nuk është paraqitur dokumenti katalog.
- Operatori ekonomik "Fusha" shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: "*Operatori ekonomik duhet të disponojë 950 (nëntëqind e pesëdhjetë) konteniere....*", pasi kontrata e furnizimit të kontenirëve nuk i

referohet objektit të procedurës së prokurimit: ” **Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III**”

7. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Ante-Group” shpk

- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 2 të Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2014, 2015, 2016) lëshuar nga Autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: 494,683,652 (katërqind e nëntëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH*”, pasi xhiro mesatare për tri vitet e kërkuara rezulton në vlerën e kërkuar por ne shifren 163,687,957 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 6 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 9001 – 2008 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten ISO)*”, pasi certifikata rezulton e papërkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 14001 – 2004 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten ISO)*”, pasi certifikata rezulton e papërkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë BS OHSAS 18001 – 2007, për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme) (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten BS OHSAS)*”, pasi certifikata rezulton e papërkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV dhe librezë pune*”, pasi për inxhinierin mekanik nuk është paraqitur librezë e punës.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*1 (një) Inxhinier Mjedis, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, librezë pune dhe Çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis*”, pasi për inxhinierin e mjedisit nuk është paraqitur librezë e punës.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 4 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë. Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: Kontratë Pune e vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, Librezë Pune, Diplomën përkatëse. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë dhe ta vërtetojë me dokumentacionin e mësipërm*”, pasi për mjekun nuk është paraqitur

libreza e punës.

- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”*, pasi për Mjekun e Përgjithshëm dokumentacioni është paraqitur fotokopje i pashoqëruar me vërtetimin e Noterizimit/njehsim I kopjes origjinale me atë fotokopje.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 5 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Një punësim mesatar i të paktën 150 (njëqind e pesëdhjetë) personave, për periudhën Korrik 2016- Korrik 2017 të vërtetuar me: a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Korrik 2016- Korrik 2017 ; b. List-pagesat e punonjesve sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Korrik 2016- Korrik 2017 shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”*, pasi nuk është paraqitur vërtetim nga Administrata Tatimore si dhe nuk janë paraqitur formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 1 të Kapaciteti Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“(b)vërtetim nga fushë depozitimi përkatës mbi depozitimin e mbetjeve”*, pasi nuk është paraqitur vërtetim nga fushë depozitimi përkatës për depozitimin e mbetjeve.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 11 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme...”*, pasi nuk është paraqitur një deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë e mjeteve të kërkuara.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 12, gërma “e” të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (origjinal ose kopje e noterizuar)”*, pasi në kontratën e porosisë nuk është përcaktuar afati i ekzekutimit të porosisë.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 12, gërma “e” të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të porositur, vitin e prodhimit të tij, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur (origjinal ose kopje e noterizuar)”*, pasi nuk janë paraqitur katalogët përkatës.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 12, gërma “g” të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Për mjetet në pronësi/qera apo të porositura, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti*

Kontraktor brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, do të s'kualifikohet dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar; vijues në renditje”, pasi nuk është paraqitur deklarata e mësipërme.

- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 13, të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 950 (nëntëqind e pesëdhjetë) konteniere. Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë...”, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e këtij kriteri.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk nuk plotëson pikën 14, të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet : «Specifikime Teknike », të firmosura e vulosura dhe grafikun e kryerjes së shërbimit të pastrimit sipas afateve të përcaktuara në specifikimet teknike”, pasi nuk është paraqitur asnjë dokument për përmbushjen e këtij kriteri.

8. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” shpk

- Operatori ekonomik “Rej” shpk nuk plotëson pikën 2 të Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2014, 2015, 2016) lëshuar nga Autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht: 494,683,652 (katërqind e nëntëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH”, pasi nuk plotëson vlerën e kërkuar.
- Operatori ekonomik “Rej” shpk nuk plotëson pikën , gërma “a” të Kriterëve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:a. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5”; pasi nuk është paraqitur deklarata.
- Operatori ekonomik “Rej” shpk nuk plotëson pikën , gërma “b” të Kriterëve të vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:b. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6”, pasi nuk është paraqitur deklarata.
- Operatori ekonomik “Rej” shpk nuk plotëson pikën 1 të Kriterëve të Përgjithshme të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Kërkesat si më sipër; plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 8 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore”, pasi nuk është paraqitur deklarata për gjendjen gjyqësore.
- Operatori ekonomik “Rej” shpk nuk plotëson pikën 11 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasisë përkatëse për mjetet e mëposhtme...”, pasi nuk është paraqitur një deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasisë e mjeteve të kërkuara.
- Operatori ekonomik “Rej” shpk nuk plotëson pikën 12 të Kapacitetit teknik të

Dokumentave Standarte të tenderit: “Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – f, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë...”, pasi nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar.

- Operatori ekonomik “Rej” shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Operatori ekonomik duhet të disponojë 950 (nëntëqind e pesëdhjetë) konteniere. Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë...”, pasi nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar.
- Operatori ekonomik “Rej” shpk nuk plotëson pikën 14 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet : «Specifikime Teknike », të firmosura e vulosura dhe grafikon e kryerjes së shërbimit të pastrimit sipas afateve të përcaktuara në specifikimet teknike”, pasi nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatorin ekonomik “Alko Impex General Constructions” degë e shoqërisë së huaj me adresë: Rr.“Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga, Kati 8, prane Stacionit te Trenit, Tirane** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 473,765,974 (katërqind e shtatëdhjetë e tre milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi “Skenderbej”, Nd. 2, 1001, Tiranë, disponibilitetin e mjeteve dhe konteniereve, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi dhe rrjedhimisht sigurimin e kontrates 5 (pese) dite pas verifikimit fizik te mjeteve dhe konteniereve.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 11.01.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur ankesa nga bashkimi i operatoreve ekonomike “Shpresa” shpk &” Dion Texnikh” A.E, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 1998. Prot. datë 15.01.2018 (administruar në dosjen e prokurimit) për trajtimin e së cilës është ndjekur procedura e parashikuar në Kreun VII, Neni 63, pika 3 dhe pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun X, Neni 78 pika 5 dhe pika 6 te VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe në përfundim i është kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës me Nr. 1998/2 Prot. datë 22.01.2018;

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga pala ankimuese pranë Komisionit të Prokurimit Publik në mbështetje të Nenit 63, pika 6 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), bashkimi i operatoreve ekonomike “Shpresa” shpk &”JV Dion Texnikh” A.E paraqiti ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 4143.Prot, datë 29.01.2018 dhe me anë të shkresës Nr. 4143/1.Prot, datë 09.02.2018, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë i dërgoi Komisionit të Prokurimit Publik të gjithë informacionin e nevojshëm për këtë procedurë prokurimi. Me anë të shkresës Nr. 9806.Prot, datë 08.03.2018, Komisioni i

Prokurimit Publik dërgoi Vendimin Nr.100/2018 për mospranimin e ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomike “Shpresa” shpk &”JV Dion Texnikh” A.E.

Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, , propozon të shpallet fitues, për procedurën e prokurimit me objekt: **“Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana III”**, Operatorin ekonomik **“Alko Impex General Constructions”**, degë e shoqërisë së huaj.

